



MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT

KJO MARRËVESHJE ËSHTË BËRË ME:

10/JANR/2020

NË MES TË:

KOMUNËS SË GJAKOVË, REPUBLIKA E KOSOVËS

DHE

OJQ BETHANY CHRISTIAN SERVICES (BCS) - Gjakovë, Kosovë

ME QË Komuna e Gjakovës dhe **BCS** -ja kanë identifikuar kërkesën e përbashkët për të përkrahur përfshirjen sociale të fëmijëve në sistemin e edukimit parashkollorë në veqanti të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Gjakovës

ME QË Komuna e Gjakovës dhe **BCS** -ja kanë bashkëpunuar në dizajnimin e projektit me qëllim të standardizimit të programit për Zhvillimin dhe Edukimin në Femijërinë e hershme në Komunën e Gjakovës.

ME QË Komuna e Gjakovës dhe **BCS** -ja dëshirojnë që ta ndihmojnë dhe ta ngrisin pjesëmarrjen e barabartë përmes përmirësimit të jetës së fëmijëve në veqanti atyre nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Gjakovës

ME QË Komuna e Gjakovës dhe **BCS** -ja dëshirojnë të shohin që ky projekt të arrijë sukses sa më të madh të mundshëm.

NENI 1

Përkufizime

1.1 “BCS-ja” d.m.th. **Bethany Christian Services** – Gjakovë, Kosovë

1.2 “**Komuna**” d.m.th. Komuna e Gjakovës, Kosovë

NENI 2

Deklarim i përgjithshëm

2.1 Që palët pajtohen që të punojnë së bashku duke përdorur njohurinë dhe burimet më të mira të tyre, të shkëmbejnë informatat dhe të dhënat, duke krijuar një mjedis të qartë dhe komunikim transparent.

NENI 3

Me mbështetjen e UNICEF-it në Kosovë dhe angazhimin e institucioneve arsimore përkatëse, OJQ Bethany Christian Services do të punojë në drejtim për të siguruar që fëmijët më të rrezikuar të grupmoshave 3-6 vjeç, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët nga grupet e cenueshme (komunitetet pakicë në Gjakovë) dhe ata me vështirësi në zhvillim (CwD), të kenë qasje dhe të shfrytëzojnë një vazhdimësi cilësore të mësimit dhe edukimit të hershëm duke krijuar qendra të sigurta dhe miqësore ndaj fëmijëve në komunitete, të bazuara në Zhvillimin dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme (ECD Program) në komunën e Gjakovës.

Qëllimi i projektit

3.1 Qëllimi i projektit “Përfshirja arsimore dhe sociale përmes programit të zhvillimit në fëmijërinë e hershme në Komunën e Gjakovës” është:

Forcimi i kapaciteteve të strukturave lokale për të promovuar përfshirjen sociale dhe për të përmirësuar mirëqenien e fëmijëve dhe nënave më të rrezikuara në komunitetet pakicë të Komunës së Gjakovës ku si rezultat kemi:

- **Rezultati 1:** Krijuesit e politikave lokale zotohen dhe angazhohen për të zhvilluar dhe zgjeruar programe të EFH për të gjithë fëmijët 0-6 vjeç, veçanërisht nga romët, Ashkali dhe Egjiptianit në Komunën e Gjakovës
- **Rezultati 2:** Prindërit, kujdestarët, përfaqësuesit e komuniteteve dhe autoritetet komunale kanë njohuri, mirëkuptim dhe aftësi për të promovuar përfshirjen sociale të grupeve në nevojë
- **Rezultati 3:** Rritja e aftësive të edukatorëve dhe kujdestarëve për të ofruar cilësi arsimore të fëmijërisë së hershme dhe shërbime të zhvillimit të fëmijërisë së hershme për fëmijët në fshatrat e largëta të synuara në Komunën e Gjakovës.

NENI 4

Financimi

- 4.1 Financimi kryesor i projektit do të bëhet nga UNICEF ne Kosovë dhe BCS por për një pjese të projektit pritet që të ketë pjesëmarrje edhe Komuna e Gjakovës përmes Drejtorisë për Arsim – DA, ne varëshmëri të nevojave pas përfundimit te fazes se parë të projektit
- 4.2 Përcaktimi i buxhetit për fazën e parë të projektit duke filluar nga data 01.10.2019 deri më 30.09.2020 bëhet nga **BCS** ndërkaj për vitet vijuese 2020 e më tej bugjeti hartohet në bashkëpunim me DA-Komuna e Gjakovës dhe me miratim të Kuvendit Komunal - Gjakovë.

NENI 5

Obligimet

BCS-ja pajtohet që të:

- Harton projekt propozimin “Përfshirja arsimore dhe sociale përmes programit të zhvillimit në fëmijërinë e hershme në Komunën e Gjakovës”
- Të bashkëpunoj në organizimin e takimeve ndërmjet Komunës – Kuvendi Komunal – Gjakovë, Drejtoria për Arsim-DA, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë-Republika e Kosovës, Inspektoratin e Arsimit në Gjakovë, ZKKK-Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim ,përfaqësues e prindër të fëmijëve me specifik ata të komuniteteve rom,ashkali dhe egjiptian në Gjakovë;
- Të kontriboj në shpenzimin e pagave për punonjës në kuadër të projektit dhe rregullimin e infrastrukturës (klasave) për nxënës parashkollorë 3-6 vjeq në kuadër të Qendrës Mësimore në lagjen Brekoc;
- Të mbështes Komunën e Gjakovës në zhvillimin e implementimin e strategjisë për Edukimin Parashkollorë mbështetur në Ligjin për Edukimin Parashkollorë dhe zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse të fëmijëve në shkollimin parauniversitar
- Të ofroj program edukativ dhe arsimor për fëmijë parashkollorë 3-6 vjeq në Qendrën Mësimore në Brekoc
- Të ofroj trajnime mbështetëse për ngritje të kapaciteteve profesionale të 50 edukatorëve për parashkollorë në komunën e Gjakovës
- Të monitoroj zbatimin e punëve dhe të përpiloj raportet vlerësuese në fund të projektit.

NENI 6

Obligimet

Komuna e Gjakovës pajtohet që të:

- Përmes Drejtorisë Komunale të Arsimit-DA të garantoj bashkëpunimin me organizatën zbatuese të projektit Bethany Christian Services – në Gjakovë në drejtim të realizimit të qëllimit të projektit
- Të shqyrtoj mundësinë për mbulimin e shpenzimeve të programit përgjatë vitit 2020 e tutje gjithnjë sipas nevojës dhe kërkesës për arritjen e synimeve të projektit;

- Të shqyrtoj mundësinë për mbulimin e shpenzimeve për obligimet komunale (rrymë,ujë,mbeturina) të Qendrës së Komunitetit në lagjen Brekoc përgjate vitit 2020 dhe më tej;
- Të shqyrtoj mundësinë që të krijoj bugjet të veçantë dhe të bashkëpunoj për implementimin e udhëzimeve administrative dhe rregulloreve të cilat dalin nga niveli qendror me qëllim të sigurimit të finacimit dhe mbulimit të shpenzimeve për punë edukative me nxënës të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (pagat,shpenzime komunale,inventarizim të nevojshem) duke përfshirë ketu kontributin e prindërve si dhe mbështetjen eventuale të donatorëve të tjerë;
- Përmes Drejtorisë Komunale të Arsimit të participoj në monitorimin dhe vlerësimin e projektit përgjatë zbatimit të tije në vitin 2019/20 dhe më tej

NENI 7

Besueshmëria

- 7.1 Gjatë rrjedhjes së projektit informatat e privileguara do të jenë në dispozicion për të gjithë partnerët në mënyrë që objektivat e projektit të zbatohen me efekt.
- 7.2 Të gjithë partnerët pajtohen që të mos zbulojnë ndonjë informatë të privilegjuar palëve tjera jashtë projektit pa miratimin e të gjithë partnerëve.

NENI 8

Raportimi

- 8.1 **BCS**-ja pajtohet që të mbaj të dhënat e plota mbi aktivitetet dhe shpenzimet që rrjedhin gjatë projektit.
- 8.2 **BCS**-ja pajtohet që ti bëj të gatshme këto të dhëna dhe të bëj raporte siç janë pajtuar të dy palët gjatë projektit.

NENI 9

Bashkërenditja e projektit

- 9.1 Komuna e Gjakovës dhe Drejtoria e Arsimit në Gjakovë dhe BCS-ja do ta kenë rolin kryesor në udhëqjen e projektit dhe përmbushjen e objektivave brenda tij.

NENI 10

Kohëzgjatja e marrëveshjes

- 10.1 Kohëzgjatja e marrëveshjes vlen deri me 30.10.2020 nga dita e fillimit të zbatimit të programit.

- 10.2 Kjo marrëveshje do të veproj datën kur të gjitha palët të kenë nënshkruar marrëveshjen.
- 10.3 Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me miratimin me shkrim të palëve pa ju shmangur principeve të projektit.

NENI 11

Mbarimi i marrëveshjes

- 11.1 Ky Memorandum i Mirekuptimit mund të mbaroj nga secila palë para përfundimit të projektit duke dhënë një njoftim me shkrim 30 ditësh palës tjetër.

NENI 12

Klauzola përfundimtare

- 12.1 Kjo marrëveshje është përgatitur në 2 kopje ku secila palë do të mbajë nga një kopje.
- 12.2 Secila palë do të jetë e lidhur me të gjitha kushtet e kësaj Marrëveshjeje.
- 12.3 Kjo marrëveshje përbënë të vetmën dhe të tërën e Marrëveshjes në mes të palëve. Asnjë ndryshim, modifikim nuk do të jetë i efektshëm vetëm nëse të dy palët nënshkruajnë një shtesë me shkrim.

Komuna e Gjakovës dhe BCS-ja pajtohen që ti përmbahen kushteve të kësaj marrëveshje duke nënshkruar më poshtë:

Për Komunën e Gjakovës



Ardian Gjini

Kryetar i Komunës

Datë: 10.01.2020

Për OJQ Bethany Christian Services



Berat Thaçi

BCS-Drejtor Ekzekutiv

Datë: 10.01.2020